



**V E N D I M**

**Nr. 8, Datë 14/07/2016**

**"PËR MIRATIMIN E KRITEREVE TË VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE  
PËR PERSONEL AKADEMIK TË FTUAR NË UNIVERSITETIN E ARTEVE  
PËR VITIN AKADEMIK 2016-2017"**

Në zbatim të, nenit 3, (*Liria akademike dhe autonomia e institucioneve të arsimit të lartë*), neni 38 (*Funksionet e Senatit Akademik*), neni 39 (*Rektori*), neni 62 (*Personeli akademik i ftuar*), "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*", Senati Akademik i Universitetit të Arteve, pasi u njoh dhe diskutoi me dokumentacionin e paraqitur nga Drejtorja Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, mbi kriteret e vlerësimit të kandidatëve për pedagogë të ftuar (miratuar nga të tre fakultetet) në Universitetin e Arteve për vitin akademik 2016-2017,

**VENDOSI**

1. Miratimin e kriterëve të vlerësimit të kandidatëve për personel akademik të ftuar, në Universitetin e Arteve për vitin akademik 2016-2017, sipas Lidhjes 1 të këtij Vendimi.
2. Vendimi të publikohet në faqen zyrtare (internet) të Universitetit të Arteve.

**Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

**Prof. Kastriot ÇAUSHI**

**Prof. Dr. Zana SHÛTERIQI (PRELA)**





Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Asoc. Ardian ISUFI

Prof. Sadik SPAHIJA

Prof. Asoc. Vladimir MYRTEZAI (GROSHA)

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Fatmir MIZIRI

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Miltiadh KUTALI

Prof. Petrika AFEZOLLI

Prof. Bujar SYKJA

Prof. Asoc. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Asoc. Elvis RUDI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Nansy GJERAZI

Rafael HOXHA






**KRITERET PËR VLERËSIMIN E KANDIDATËVE PËR PERSONEL AKADEMIK TË  
FTUAR PËR VITIN AKADEMIK 2016-2017  
NË UNIVERSITETIN E ARTEVE**

**I. Kriteret bazë për dosjet e konkurrentëve:**

Përzgjedhja e personelit akademik të ftuar në UART bëhet përmes konkurrimit me dosje, sipas kërkesave të fakulteteve të Universitetit të Arteve si dhe mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë, VKM Nr. 331, datë 25.3.2009 "Për ndarjen në nivele, brenda kategorive, të personelit akademik, në institucionet e arsimit të lartë, emërtimin e renditjen e tyre, si dhe kriteret dhe kualifikimet për secilin vend pune", akteve të tjera ligjore dhe nënligjore të dala për këtë qëllim.

1. Dosja e kandidatit për personel akademik i ftuar duhet të përmbajë Jetëshkrimin (CV) me të dhënat e shoqëruara me dokumentacion:
  - 1.1. Të dhëna të noterizuara të arsimimit të kandidatit;
  - 1.2. Të dhëna të noterizuara të kualifikimeve pasuniversitare të kandidatit (Tituj dhe Grada Shkencore);
  - 1.3. Të dhëna për biografinë artistike dhe/ose shkencore të kandidatit duke filluar nga periudha e pas studimeve;
  - 1.4. Të dhëna për përvojën pedagogjike të kandidatit pranë IAL-ve (jo me pak se 3 vjet);
  - 1.4. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar;
  - 1.5. Dëshminë e gjendjes gjyqësore;
  - 1.6. Dëshminë mjeko ligjore;
  - 1.7. Çertifikatë familjare/fotokopje e katrës së identitetit.
2. Të dhënat e legalizuara të kualifikimeve pasuniversitare të kandidatit do të vlerësohen vetëm nëse janë në specialitetin e kërkuar apo programin e studimit në të cilin konkurren.
3. Konkurrentët të jenë diplomuar në ciklin 4-vjeçar të studimeve ose të jenë diplomuar në ciklin e dytë të studimeve Master.
  - 3.1. Të jenë diplomuar në Specialitetin dhe fushën përkatëse në sistemin me kohë të plotë brenda ose jashtë vendit, sipas kërkesave të Departamenteve për lëndën që nuk janë të fushës së artit, preferenca dytësore në lidhje me diplomimin e tyre.
  - 3.2. Kandidati/tja, e diplomuar jashtë vendit, duhet detyrimisht ta kenë të njehsuar diplomën në MAS.
4. Konkurrentët që janë mbajtës të titullit akademik "Profesor" apo "Profesor i Asociuar" (kategoria Profesor), dhe që janë bashkëpunëtorë në kohështrirje me fakultet e Universitetit të Arteve, me propozim të Përgjegjësit të Departamentit dhe me vendim të Dekanit të Fakultetit kanë përparësi. Për këto personalitete mjafton vetëm një kërkesë dhe fotokopje e dokumentit të titullit.





5. Për personalitete të fushës të artit që ofrohen të japin mësim në Universitetin e Arteve, nuk merret në shqyrtim dosja e tyre. Në këto raste Dekani i fakultetit shprehet me një Vendim të posaçëm për to.
6. Të gjithë konkurrentët të cilët nuk kanë Titull akademik apo gradë shkencore duhet ta kenë notën mesatare të shkollës së lartë mbi 8.
7. Për kandidatët që nuk kanë vite pune në mësimdhënie, Përgjegjësi i Departamentit dhe Dekani, duhet të shprehen me një vendim të veçantë për to, për arsyet e marrjes në mësimdhënie.
8. Në veprimtarinë pedagogjike të Kandidatit në periudhën e pas studimeve do të vlerësohet me përparësi përvoja pedagogjike pranë IAL-ve dhe më parësore ajo në Universitetin e Arteve, si dhe rezultatet e bashkëpunimit ndër vite.

## II. Kriteret e përgjithshme: Gjithsej 50 pikë

### 1. Kualifikime dhe aktiviteti shkencor.

- Doktor brenda vendit **10 pikë**
- Doktor jashtë vendit **15 pikë**
- Tekst mësimor i botuar. **5 pikë**
- Artikull/artikuj shkencorë të botuara brenda vendit, **5 pikë**
- Artikull/artikuj shkencorë botuar jashtë vendit, **5 pikë**

### 2. Përvojë pune në mësimdhënie në profesionin e kërkuar.

- Çdo 1 vit pune në mësimdhënie në specialitetin për të cilin konkurron vlerësohet me 1 pikë.
- Maksimalja e pikëve për këtë vlerësim është **10 pikë.**

## III. Kriteret artistike dhe profesionale: Gjithsej 50 pikë

### 1. Interpretime dhe vepra artistike etj.

- Aktivitete artistike individuale **15 pikë**
- Vepra të vëna në skena prestigjioze, koncerte solistike, ekspozita individuale, etj. **15 pikë**
- Pjesëmarrje kolektive në aktivitete artistike brenda vendit **10 pikë**
- Pjesëmarrje kolektive në aktivitete artistike jashtë vendit **10 pikë**

**V.O. Dosja e secilit prej konkurrentëve për personel akademik të ftuar për vitin akademik 2016-2017, do të vlerësohet në maksimalen e saj me 100 pikë.**

**Vlerësimi pozitiv i Përgjegjësit të Njesisë Bazë për Punonjësit Mësimorë të Ftuar, për vitin akademik 2015-2016 do të merren në konsideratë (prioritet).**





**Këto kritere hyjnë në fuqi për konkurset që do të zhvillohen për punonjës mësimorë të ftuar për vitin akademik 2016 - 2017.**

**"PËR MODALITETIN E PRANIMIT TË PEDAGOGËVE TË FTUAR PËR VITIN  
AKADEMIK 2016 - 2017"**

1. Bazuar në shtimin e numrit të punonjësve efektivë, të kufizohet numri i punonjësve akademikë të ftuar.
2. Asnjë person nuk do të marrë pjesë së procesin mësimor pa u miratuar si pedagog i ftuar.
3. Asnjë nga kandidaturat e përzgjedhura nga konkursi, nuk do të miratohet si pedagog i ftuar, nëse brenda afatit të njoftuar nuk do të paraqesi në Degën e Burimeve Njerëzore, ku përveç kritereve të konkurimit, kërkohet:
  - a. të vërtetojë përvojën akademike,
  - b. të vërtetojë pajtueshmërinë e përvojës akademike me fushën në të cilën do të ushtrojë veprimtarinë akademike,
  - c. të paraqesë 2(dy) rekomandime nga profesorë të institucioneve akademike nga vijnë,
  - d. të vërtetojë që lejohen nga qendra e punës për t'u angazhuar si pedagog i ftuar në institucionin tonë,
  - e. të nënshkruaj kontratën e punës për atë periudhë që lejohet të angazhohet në institucionin tonë.
4. Pedagogët e ftuar, pas miratimit, në raport me kohën që janë të angazhuar në Universitetin e Arteve, duhet t'u nënshtrohen të gjitha rregullave disiplinore, pasi kanë të gjitha të drejtat dhe detyrimet që kanë edhe pedagogët efektivë.
5. Trajtimi financiar i pedagogëve të ftuar do të bëhet pasi të kenë plotësuar modalitetet e pranimit të tyre.
6. Të mos planifikohet asnjë punonjës i administratës si pedagog i ftuar.
7. Për zbatimin e kritereve ngarkohen Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Dekanët dhe Shefat e Departamenteve të Fakulteteve.